



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
***Kuvendi - Skupština – Assembly***

---

Legjislatura VIII  
*Sesioni pranveror*

**Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,  
për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione**

P-nr.93/2024

Prishtinë, më 10.07.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Arjeta Fejza Albana Bytyçi, Fatmire Kollçaku, Drita Millaku, Labinotë Demi- Murtezi, Nasuf Bejta, Ariana Musliu Shoshi, Eliza Hoxha dhe Marigona Geci.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerim Hasani-MFPT, Arsim Berisha - zv.ministër në MSH, Artan Ahmeti- MFPT, Agon Dobruna - zv.ministër në MFPT, Afrim Maliqi-HANDIKOS dhe Rrustem Gashi-HANDIKOS, Besarta Pllana-Kuvendi i Kosovës, Hysni Mehani-GP-LVV, Dorentina Merturi – Kuvendi i Kosovës, Genti Ramosaj- Kuvendi i Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi Duda Balje, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim në Komision lidhur me plotësimin apo ndryshimin e Rregullores (QRK) nr. 07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, ose nxjerrjen e Rregullores së re;  
Të ftuar: ministri i MFPT-së, ministri i MSH-së, si dhe drejtori i Shoqatës HANDIKOS.
3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara;
4. Të ndryshme.

\*\*\*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetarja**, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Diskutim në Komision lidhur me plotësimin apo ndryshimin e Rregullores (QRK) nr. 07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, ose nxjerrjen e Rregullores së re; Të ftuar: ministri i MFPT-së, ministri i MSH-së, si dhe drejtori i Shoqatës HANDIKOS.**

**Kryetarja**, njoftoi anëtarët e komisionit se të pranishëm në mbledhje janë përfaqësuesit nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, Ministria e Shëndetësisë dhe përfaqësues të shoqatës HANDIKOS për të diskutuar së bashku, lidhur me plotësimin apo ndryshimin e Rregullores (QRK) nr. 07/2017 për Përbërjen, Funkcionimin, Përgjegjësitë e Komisionit Vlerësues dhe Përcaktimin e Procedurave për Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, ose nxjerrjen e Rregullores së re. Fjalën ia kaloi zëvendësministrit të Financave Punës dhe Transfereve.

**Agon Dobruna**, tha se MFPT si sponsorizuese e kësaj rregulloreje, së bashku me HANDIKOS-in, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura dhe rregullorja është përfunduar. Kjo rregullore ishte paraparë të përfundojë në janar të këtij viti, por kemi pasur me i diskutuar edhe disa çështje më të ndjeshme, duke pasur parasysh që me këtë rregullore prekim një shtresë të cënueshme të shoqërisë dhe është munduar të bëhet më e mira e mundshme.

Ai shtoi se me shoqatën HANDIKOS, janë pajtuar me mbi 90% të çështjeve të ngritura dhe javën e kaluar rregullorja është dërguar në thesar për koston e buxhetit dhe në Zyrën e Kryeministrit për harmonizim, afati ligjor është 15 ditë dhe pritet që në ditët vijuese kjo rregullore të miratohet në qeveri.

Besojnë se shumë gjëra kanë me ndryshuar për të mirë të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Ai njoftoi se me rregulloren e re nuk do të ketë rivlerësime, do të jetë vlerësimi i përhershëm dhe me këtë nënkuptohet se hiqen radhët nëpër zyrat e HANDIKOS dhe zyrat e ministrisë.

Komisioni vlerësues deri tani nuk ka qenë në kompetencë të drejtpërdrejt të MFPT-së, ndërsa tash do ta kontraktojnë sipas ligjit të Prokurimit Publik, komisioni nuk do ta shoh vetëm gjendjen shëndetësore të aplikuesit por do të merret edhe me funksionalitetin, punësimin, riaftësimin, nevojat sociale.

Deri me tani komisioni ka qenë vetëm për nevojat shëndetësore dhe tani është shkuar një hap tutje, është e rëndësishme të ceket se personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë i kanë sjell në gjendje të rëndë shëndetësore për aplikim dhe vlerësim, tani aplikimi mund të bëhet mënyrën online dhe ata që nuk kanë mundësi transporti, komisioni i vlerësimit do të shkojë në shtëpinë ku banojnë dhe do të jetë gjithçka më e lehtë.

Përcjellësi për njëri kategori do të jetë i përhershëm ndërsa për kategorinë tjetër mund të jetë i përhershëm, mirëpo, mund të jetë me rivlerësim nga komisioni vlerësues mbas tri viteve nëse konstatohet se mundet me pas përmirësimin e pacienti.

Njoftoi se kanë siguruar një financim nga BE-ja që të monitorojnë punën e komisioneve, punën profesionale dhe kualitetin e vendimeve.

Deri më tani komisionet tona nuk i kanë dhënë vendim palës, një person është refuzuar dhe nuk e ka ditur pse është refuzuar, ndërsa tani do ta ketë vendimin, me rregullore pjesa e shqyrtimit administrativ të kërkesës do të jetë 15 ditë, ndërsa shqyrtimi do të jetë 30 ditë.

Në dy raste mund të ketë rivlerësim, përjashtimisht, nëse personit i përkeqësohet gjendja, nëse ka plagë dekubitare apo nëse ndonjë gjë tjetër që i duhet shtesë, atëherë thirren në komision dhe e dyta është kur nga monitoruesit e ministrisë vërehet se dikujt i është bërë e padrejtë, atëherë do të kthehet personi në rivlerësim.

Ai shtoi se përgjegjësia do ta rrisin në ministrinë e tyre tek komisionet vlerësuese, komisioni vlerësues nuk do të jetë i përberë vetëm nga mjekët, do të ketë edhe nga puna dhe mirëqenia sociale dhe një anëtarë nga organizatat tjera.

**Kryetarja**, tha se tek këta persona janë hasur shumë probleme, nga ajo që u pa këtu po del se nuk do të ketë problem sa i përket kostos financiare dhe kjo është pozitive.

**Arsim Berisha**, tha se rregullorja është sponsorizua nga MFPT, ndërsa Ministria e Shëndetësisë ka aprovuar një udhëzim administrativ nr.11/2022, për përcaktimin e listës së llojeve dhe pajisjeve ndihmëse që ofrohen falas për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që shërbejnë për lëvizje parandalim dhe asistim për personat me aftësi të kufizuar, e që si dokument është miratuar nga qeveria në vitin 2022. Ndërsa, institucioni zbatues i këtij dokumenti për këto shërbime është institucioni spitalor i Kosovës. Ministria e Shëndetësisë për gjithçka që ka të bëjë me përmirësimin e gjendjes shëndetësore të personave me aftësi të kufizuar është e gatshme të bashkëpunojë me të gjitha dikasteret tjera që janë përgjegjëse në këtë drejtim.

**Kryetarja**, tha se janë të njoftuar se nga QKUK, personat që janë më në moshë janë përjashtuar nga mundësia për me marrë ndonjë pajisje që atyre ju shërben.

**Arsim Berisha**, tha se ai nuk e ka një informatë të tillë, ndërsa theksoi se është ndarë buxheti për dy vitet, për secilin vit nga 3.2 milion euro për sigurimin e pajisjeve, gjithmonë në bashkëpunim me HANDIKOS-in.

**Afrim Maliqi**, personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë janë më të rrezikuarit në mesin e personave me aftësi të kufizuara, ndër vite kanë vërejtur se si pasojë e rregullores që nuk ka qenë fare e mirë edhe komisionet që kanë bërë vlerësimet dhe edhe ministria e ka pranuar se komisionet kanë dështuar dhe se nuk kanë mundur të i ndërrojnë komisionet dhe ka qenë defekti edhe i rregullores e edhe i komisionit.

Ai tha se besojmë se rregullorja e re është shumë më e mirë se ajo që ishte deri tani. Nga mediat është pyetur nëse është rritur numri i personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, tha se është rritur numri sepse në këtë vit komisionet kanë filluar me bërë vlerësimin me të drejtë të këtyre personave dhe se shumë persona kanë ngritur padi dhe i kanë fituar rastet.

**Kryetarja**, pyeti se nëse shkohet me padi kush e paguan procesin gjyqësorë?

**Afrim Maliqi**, tha se ekspertët i paguan vet personi, janë dy shkallë të ekspertëve, ndërsa prej pagesës se padisë janë të liruar këta persona, por ekspertët duhet të paguhet.

Sa i përket udhëzimit administrativ për pajisje ndihmëse për këta persona, fatkeqësisht ky udhëzim administrativ katër herë ka shkuar deri në qeveri dhe në fund ka gjetur zbatim që në fakt personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë do të pajisen me pajisje ndihmëse për lëvizje, për asistim dhe për parandalim, tha se kanë informata se është zgjedhur kontraktuesi.

Personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët kanë pasur subvencione të energjisë elektrike e që tani sipas programit të qeverisë do të duhej t'i përmbushnin kriteret që ti kenë 150 euro për anëtarë të familjes. Ai përmendi se së bashku me bashkëshorten punojnë dhe marrin të ardhura më shumë se 150 euro në muaj dhe deri vitin e kaluar ka pasur subvencionim për energji elektrike por më nuk ka. Tha se ligji për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë sa i përket të ardhurave bazohet në pagën minimale dhe ka filluar zbatimin në vitin 2017 dhe që nga atëherë ka mbetur në atë shumë dhe ky është një regres.

Ai shtoi se vitin e kaluar ka qenë në konsultim publik Projektligji për Kodin Doganor, dhe se kanë dhënë komentet dhe rekomandimet e tyre, ndërsa kur e kanë parë raportin që e ka publikuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, kanë vërejtur se kërkesat e tyre kanë qenë fare pa përgjigjeje, janë takuar edhe me Komisionin parlamentar për Buxhet dhe Financa dhe kanë premtuar se do të bëjnë diçka, por, nuk është bërë asgjë deri më tani.

Njoftoi se në vitin 2022 kur ka qenë vit i dedikuar për personat me aftësi të kufizuar ka qenë e paraparë dhe obligim i Ministrisë së Shëndetësisë të bëhet themelimi i Njesisë Spinale në kuadër të QKUK-së, dhe kjo njësi nuk është themeluar, të gjitha vendet në rajon e më gjerë kanë njësi spinale.

**Ariana Musliu- Shoshi**, pyeti zëvendësministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, se pse kjo kategori e personave është larguar nga përfitimi i pagës minimale, se këtë çështje e kanë ngritur edhe në Kuvend dhe nuk kanë marrë përgjigjeje.

**Agon Dobruna**, tha se për një kohë të gjatë ligjin për pagën minimale e kanë pasur të bllokuar, se kjo çështje është e më hershme dhe nuk mund të jep përgjigjeje të saktë, mirëpo, për secilën çështje që u ngrit këtu është i gatshëm të bashkëpunoj me të gjithë për të gjetur zgjidhje.

**Arjeta Fejza**, tha se ndihet mirë që palët janë të kënaqura me rregulloren e re, duhet të ketë më shumë kujdes në procesin e komisionit sepse kjo nuk ka qar në funksionimin e mirë të rregullores, sepse nëse komisioni nuk do të jetë në gatishmëri, në nivel të detyrës qoftë profesionalisht, apo edhe në aspektin e ndjeshmërisë, nuk mund të ketë sukses në proces. Theksoi se është përgjegjësi e institucioneve, që ashtu siç kanë bashkëpunuar në draftimin e rregullores të ketë kujdes edhe në përzgjedhjen e komisionit vlerësues.

**Kryetarja**, tha se komisioni vlerësues ka qenë shumë i padrejtë në mënyrën se si ka refuzuar kërkesat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

**Fatmire Kollçaku**, tha se bazuar në rregulloren e re, ajo që duhet theksuar posaçërisht është risi se do të jetë vetëm një komision vlerësues, e jo dy komisione vlerësuese, siç ka qenë deri më tani. Pra, edhe përgjegjësia tani është në një vend, në një adresë, gjë që është përparësi në kuptim të vendosjes së drejtë dhe meritore për personat që aplikojnë. Çështje tjetër shumë e rëndësishme ka të bëjë me rritjen e bashkëpunimit të institucioneve kompetente me shoqatat dhe organizatat, të cilat përfaqësojnë interesat e këtij grupi, siç është shoqata Handikos dhe shumë të tjera.

Në vazhdim ajo foli edhe lidhur me çështjen e ndërlydhjes së benifiteve të tjera me pagën minimale, për çka tha se kjo qasje ka qenë e gabuar, sepse, kostoja e jetesës është shumë më e lartë. Gjithashtu ajo theksoi se çështja e zhdoganimit të veturave duhet të lidhet vetëm për emrin e personit paraplegjik ose tetraplegjik, e jo edhe për kujdestarët e tyre, sepse, në këtë mënyrë shmangen keqpërdorimet e mundshme.

**Labinothë Demi- Murtezi**, tha se shpreson se kjo rregullore e re e akteve nënligjore për të cilat folën përfaqësuesit e dy ministrive do të jetë në funksion të rritjes së shërbimeve dhe efikasitetit të tyre, për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Më tej, theksoi se aplikimi online paraqet një përparësi të madhe të cilën duhet vlerësuar, ashtu siç duhet vlerësuar edhe punën e ekipeve mobile në kuptim të ofrimit të ndihmës konkrete në terren ndaj personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë

**Eliza Hoxha**, në fillim tha se duhet vlerësuar edhe punën dhe insistimin e Komisionit për të drejtat e njeriut, për të sensibilizuar dhe mbështetur të gjitha çështjet dhe brengat me të cilat ballafaqohen personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Më tej, ajo foli edhe për çështjen e mospërfshirjes së kësaj kategorie në pagën minimale, që është brengosëse.

Në të ardhmen të gjithë ne duhet të bëjmë shumë më tepër për këta persona, në mënyrë që ata të jenë pjesë e barabartë e shoqërisë sonë.

**Marigona Geci**, në diskutimin e saj shtroi çështjen e pagesës së ulët për asistentët e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Ajo pyeti mysafirët se si do të mbetet në të ardhmen çështja e nivelit të pagesës për asistentët e asistentet e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Në vazhdim pyetjeve të anëtarëve të komisionit lidhur me çështjet për pagën minimale, klasifikimin e grupeve që kanë nevojë për kujdes shtesë, procesin e përzgjedhjes dhe mbikëqyrjes së komisionit vlerësues për këtë grup dhe ofrimin sa më kualitativ të shërbimeve profesionale dhe teknike, që përfshihen në rregulloren e re, iu përgjigjën një nga një, zëvendësministrat e lartpërmendur dhe gjithashtu sqarime të nevojshme u dhanë edhe nga drejtori i shoqatës Handikos.

Fare në fund zv/ministri Dobruna, shfaqti bindjen e tij se rregullorja e re do të hyjë në fuqi brenda muajit, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuar të kenë qasje më të lehtë shëndetësore dhe të përfitojnë nga shërbimet më të mira që parashihen.

Lidhur me çështjen tjetër të diskutimit me zëvendësministrin e MFPT-së, nuk u diskutua fare.

Ndërsa, çështja për diskutim kishte të bënte me petitionin e z. Ndue Kalaj nga Sindikata e Pavarura e Administratës dhe Judikaturës së Kosovës dhe të z. Fatmir Tasholli nga Sindikata e ish- Policëve të viteve të 90-ta, për të cilën kishte vendosur komisioni në mbledhjen e mbajtur më 19 qershor 2024, në pikën numër 3. të rendit të ditës të asaj mbledhjeje.

### **3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara;**

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 28 maj, 3 dhe 19 qershor 2024.

### **4. Të ndryshme.**

Në këtë pikë të rendit të ditës nuk u ngrit asnjë çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

*E përgatiti:*  
*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Komisionit

Duda BALJE,  
Kryetare e